



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.916/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, e me procesmbajtësin Naim Shala, në konfliktin administrativ të paditëses D.Gj nga P, rruga "I.A" nr.34, të cilën me autorizim e përfaqëson S.A, avokat në P, kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilin me autorizim e përfaqëson R.K, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palëve, me dt.20.07.2017, merr këtë,

A K T G J Y K I M

I.Aprovohet si bazuar, kërkesëpadia e paditëses D.Gj nga P. Anullohet vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me nr.1218/2015, i dt.10.04.2015 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, tek i padituri.

II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditëses, av.S.A, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së saj, aktgjykimin e Gjykatës Supreme e pranon në tërësi, i propozon gjykatës që të veprojë sipas sugjerimeve të këtij aktgjykimi. Mbi këto arsye, i propozon gjykatës, që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar.

I autorizuari i të paditurit, R.K, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë pëgjigjes në padi, duke e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, si të pa bazuar, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar. Mbi këto arsye, i propozon gjykatës që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pa bazuar, ndërsa vendimi i këshillit të mbetet në fuqi, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.20.07.2017, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi me nr.1218/2015, i dt.10.04.2015, ankesa e paditëses drejtuar Komisionit të Ankesave në AKP-së, e dt.16.12.2014, vendimi i AKP-it, nr.KZKA 1/2015, i dt.13.01.2015, komunikimi elektronik në mes Liana Xharra-Tolaj dhe paditëses, i dt.15.01.2015, dt.13.01.2015 dhe dt.17.04.2015, ankesa e paditëses, drejtuar të paditurit e dt.12.02.2015, parashtrësia e paditëses e dt.19.07.2016, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nr.AA.nr. 292/2016, i dt.08.11.2016, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ.nr.14/2017, i dt.16.05.2017.

Gjykata vlerësoi ligshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Me vendimin e të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me nr.1218/2015, i dt.10.04.2015, të goditur me padi, është hedhur poshtë e palejuar ankesa e parashtruar nga ankuesja D.Gj e dt.12.02.2015.

Paditësja e pakënaqur më të njëjtin vendim, me datë 08.05.2015, ushtron padi në këtë gjykatë, duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligji, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt, ku thuhet se “Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesja D.Gj, vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Nr.KZKA-1/2015, të datës 13.01.2015 e ka pranuar me datë 13.01.2015 nëpërmjet shkresës (e-mailit) nga zyra e personelit, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar me datë 12.02.2015. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesja ankesën në Këshill e ka parashtruar në ditën e tridhjetë e një (31), prej momentit kur e ka pranuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku thuhet “Ankesa duhet të bëhet brenda afatit prej 30 ditëve nga data kur palës i është dorëzuar vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave” dhe nenin 11 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku thuhet: “Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditësh”.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, iu referua dispozitave të Rregullorës nr.04/2014, për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 4.1 të të njëjtës, ku përcaktohet se, “Ankesa duhet të bëhet brenda afatit prej 30 ditëve nga data kur palës i është dorëzuar vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave”.

Po ashtu gjykata iu referua edhe Rregullorës nr.05/2011, për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, nenit 11, ku përcaktohet se, “Kundër vendimit të komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit prej 30 ditësh”.

Nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe atë komunikimi elektronik në mes L.Xh-T dhe paditëses, të dt.13.01.2015, gjykata vëren se, paditësja është njoftuar se kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr.KZKA-1/2015 të dt.09.01.2015 ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Paditësja, me datë 12.02.2015 ka ushtruar ankesë, me ç’rast, e paditura me vendimin e datës 10.04.2015, e hedhë poshtë si të pa lejuar me arsyetim se e njehta është ushtruar jashtë afatit ligjor.

Me këtë, gjykata konsideron se e paditura gabimisht ka llogaritur afatshmërinë e ankesës së paditëses, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 126.2 të LPK-së ku përcaktohet se “Nëse afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja”, që do të thotë se në rastin konkret nuk llogaritet data 13.01.2015, por fillon prej datës 14 të atij muaji dhe

meqenëse paditësja ankesën e ka ushtruar me datë 12.02.2015, gjykata konstaton se paditësja e ka ushtruar ankesën në ditën e 30-të, e jo siç konstaton i padituri në ditën e 31-të, kështu që ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor, qëndrim ky i dhënë edhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr. ARJ.nr.14/2017, të datës 16.05.2017.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, nuk ka zbatuar drejtë Ligjin për Procedurën Administrative dhe nuk ka zbatuar drejtë ligjin material, kur paditëses me vendimin e goditur në padi, ia ka hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri.

Në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartë cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.916/2017, dt.20.07.2017,

Procesmbajtësi
Naim Shala

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike; kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.